

# **DEPISTIMI DHE KAPJA E HERSHME E KANCERIT TE GJIRIT**

---

NE SHERBIMET E KUJDESIT PARESOR

---

Keto rekomandime jane ndertuar duke analizuar ne menyre sistematike literaturen me te fundit mbi kete fushe. Ato vlejne per te ndihmuar mjeket ne praktiken e tyre klinike me qellim ofrimin e kujdesit me te mire te mundshem shendetos. Ato do te duhet te perdoren per te ndihmuar depistimin apo kapjen e hershme te kancerit te gjirit tek grata asimptomatike te te gjitha moshave.

## C'eshte depistimi

### Perkufizimi i depistimit

Ne 1957 komisioni i semundjeve kronike ne Shtetet e bashkuara e perkufizoi depistimin si "identifikimin e semundjeve apo defekteve ne individe, nepermjet aplikimit te testeve ekzaminimeve apo procedurave te tjera te cilat mund te aplikohen ne menyre te shpejte". Nje tjeter perkufizim i vitiit 1968 eshte " Hetim mjekesor i cili nuk vjen si pasoje e e kerkeses per ndihme se nje pacienti qe ankohet nga nje problem shendetesor.

Qellimi i depistimit eshte te kapi semundjen para se shfaqjes se simptomave klinike dhe paraqitjes se pacientit per ndihme mjekesore. Pra ne rastin e depistimit iniciativa i ngelet kryesisht mjekut dhe jo pacientit. Edhe ne rastin e depistimit "opportunist" kemi te bejme me aplikimin e testeve apo procedurave ekzaminuese, gjate nje konsultimi te nje pacienti i cili ka ardhur tek mjeku per nje arsyet tjeter nga ajo per te cilen zbatohet testi depistues.

Termi kapje e hereshme mund te perdoret ndonjehere si sinonim i depistimit, por per gjithesish nenkupton nje teresi praktikash me pak specifike dhe me te per gjitheshme qe synojne rrisin ndergjegjesimin e publikut per problemet shendetshore dhe aksesin ndaj sherbimeve shendetshore per te pakesuar diagnozat e vonuara dhe me pasoja per trajtimin dhe jeten e qytetareve.

### Perse kryhet depistimi

Nje aksiome e shendetit publik thote se parandalimi primar i semundjes eshte menyra me e mire. Nese jo te gjitha rastet e semundjes mund te parandalohen, strategjia e dyte me mire ngelet kapja sa me heret e rasteve asimptomatike te semundjes, me qellim parandalimin dyesor.

Qellimi i final i aplikimit te depistimit ne popullate eshte parandalimi i semundjes. Kete qellim kjo metode e arrin permes realizimit te dy objektivave te meposhteme;

- Te kafen individet qe kane faktore rishku per semundjen
- Te kafen individet te cilet jane ne stadet e para, subklinike te semundjes

Parandalimi i kryer nepermjet depistimit eshte i tipit dytesor, pasi parandalon zhvillimin e komplikacioneve te semundjes subklinike apo parandalon zhvillimin e semundjes tek ata qe kane tashme faktore risku per semundjen. i rendesishem eshte fakti qe nepermjet depistimit ne mund te kapim personat qe jane ne risk te larte por qe nuk jane ne dijeni te ketij fakti. Pra individet qe i nenshtrohen depistimit ne per gjithesi nuk jane paciente qe shkojne tek mjeku per nje ankesa te caktuar me karakter shendetesor.

### Depistimi dhe diagnoza

Depistimi duhet dalluar nga diagnoza e cila eshte procesi i konfirmimit te semundjes. Si rezultat i diagnozes fillon mjekimi i pershtatshem nese eshte i nevojshem per semundjen ne fjale. Procedurat diagnostike perdoren per diagnostikimin e rasteve te konsideruara positive nga testi i depistimit. Keshtu aplikimi i biopsise dhe ekzaminimet e tjera do te ndihmonin ne vendosjne e diagnozes ne nje rast te konsideruar pozitiv ne mamografi.

Ne per gjithesi mungon koha, parate dhe personeli i mjaftueshem qe te vendosen diagnoza te sakta ne cdo person qe i nenshtrohet depistimit. Ne do te kishim nevoje vetem per nje test qe te na tregoje shpejt nese nje person ka shume mundesi ta kete semundjen. Pas kesaj mund te shpenzohen me shume kohe me grupin e seleksionuar nga depistimi per te vendosur diagnozen e sakte

Perparesite e perdorimit te nje testi depistim kundrejt vendosjes se diagnozes jane shpejtesia e kryerjes dhe kostoj e ulet. Te mos harrojme se depistimi kryhet ne popullaten e shendoshe dhe jo tek individet qe paraqiten tek mjeku me shenja klinike te semundjes

### Llojet e depistimit

#### *Depistimi masiv dhe depistimi selektiv*

Depistimi masiv, i njojur edhe si depistimi ne populate, ka te beje me depistimin e grupeve te tera te populates, pavaresisht nga cdo infomacion paraprak qe do ti gruponte individet ne grupe te ndryshme lidhur me nivelin e riskut.

Depistimi selektiv apo per gjedhes aplikohet ne nengrupe te populates me risk te larte per semundje si pasoje e histories familiare, moshes, apo kushteve te mjedisit. Perdorimi i kesaj menyre ka shume gjasa te rezultoje ne identifikimin me maksimal te rasteve positive, dhe perben metoden me kosto-efektive. Keshtu psh per te identifikuar grate me kancer gjiri do te ftonim vetem ato te grupmoshes 50-70 vjec ose vetem ato qe kane nje histori te caktuar familiare, e keshtu me rradhe.

### *Depistimi oportunist*

Nje program me i thjeshte dhe me i lire por jo me efektiv (perkundrazi vleresoheq qe efikasiteti i ketyre programeve eshte me i ulet se depistimi masiv) eshte depistimi oportuniste ku testi depistues nuk kryhet ne gjithe popullaten e shendoshe, por vetem ne individet qe vizitohen ne sherbimet shendetore per arsyen nga me te ndryshmet. Kryerja e nje ekzaminimi klinik te gjirit tek grata qe vijnë ne kliniken e gruas per monitorimin e femijeve te tyre do te ishte nje shembull

## DEPISTIMI I KANCEREVE

Depistimi apo skriningu masiv ne popullate eshte efektiv ne reduktimin e barres se kancereve. Ai konsiston ne aplikimin e e testeve te vlefshme (me validitet te larte), ekzaminimive apo procedurave te tjera te cilat mund te aplikohen shpejt dhe praktikisht ne popullaten e per gjitheshme (pra pa shenja te dukshme te semundjes)

Elemente thelbesore per nje program te organizuar dhe te suksesshem depistimi do te ishin vendosja e kancereve dhe teknikave prioritare paraprakisht ne strategjine kombetare te kancerit, e mbeshtetur nga nje vullnet politik per te vijuar me financimin e pershtashem nga ana e ministrise se shendetise dhe me infrastrukturen e duhur ne sistemin shendetor.

Popullata target per tu depistuar duhet perkufizuar fillimi si dhe me pas duhet informuar dhe ftuar per depistim. Nje sistem fteze dhe rifteze eshte i nevojshem per te siguruar mbulim te larte te popullates. Ne vendet me te ardhura te larta nje sistem i tille fteze mund te sigurohet permes listave te banoreve dhe dergimit te ftesave te shkruara standarte, ne vendet me te ardhura te uleta kjo mund te funksiononte permes mobilizimit te komunitetit dhe perdonimit te punonjesve shendetore ne komunitet.

Kanceri i gjirit zakonisht diagnostikohet ne stade te avancuara. Ka fakte qe deshmojne se depistimi me mamografi ne vendet me te ardhura te larta mund te redukoje vdekshmerine nga kanceri i gjirit. Gjithsesi per te arritur kete eshte thelbesore te sigurohemi para fillimit te programit te depistimit se ekzistojne kapacitetet e nevojshme, fondet dhe infrastruktura per trajtim. Eshte verejtur se trajtimi i kancerit te gjirit ne stendet e hershme eshte nje strategji shume kostofektive. Nje program masiv depistimi me mamografi dhe trajtimi perkates i kancereve te zbulura eshte gjithashtu kostofektiv, por ne vendet me te ardhura te uleta dhe sidomos me incidence te ulet veshtire se mund te keshillohet per zbatim ne praktike per arsyte te kostove shume te larta.

Kanceri i qafes se mitres apo i cerviksit eshte kanceri i dyte me i rendesishem tek grante dhe i pari ne shume vende me te ardhura te uleta. Ne shume nga keto vende ai diagnostikohet zakonisht ne stade te avancuara. Ka fakte te mjaftueshme ne ven

det me te ardhura te larta, lidhur me efektivitetin e perdonimit te depistimit me citologji per te reduktuar vdekshmerine nga ky kancer. Nderkohe qe depistimi i kancerit te cerviksit duke perdonur testimini per virusin e papilomes humane (HPV) apo inspektimin vizual me acid acetik eshte zbatuar me sukses dhe gjithashtu eshte vleresuar ne disa popullata me te ardhura te uleta dhe mund te jene nje prioritet per keto vende.

Testet e reja me kosto te ulet te depistimit per HPV, te kombinuara me vaksinim kunder HPV kane nje potencial te madh per permiresimin e kontrollit te kancerit te cerviksit ne te gjithe boten, sidomos ne te ardhmen e afert me uljen e kostove te vaksines.

Kanceri i kolonit dhe i rektumit (kanceri kolorektal) eshte kanceri me i shpeshte tek joduhanpirisit ne bote. Sisteme te ndryshme depistimi te tilla si gjaku okult ne fece, sigmoidoskopia dhe kolonoskopia jane vleresuar dhe jane perfshire tashme ne sherbimet e organizuara shendetshore te shume vendeve me te ardhura te larta. Keto programe nuk jane zbatuar ende ne vende me te ardhura te uleta, per arsyte te incidences me te ulet ne keto vende si dhe te kostos se larte dhe kompleksitetit te sherbimeve te kerkuara per vleresimin e lezioneve prekanceroze ne kolon dhe rektum.

Kanceri i prostates eshte kanceri i dyte me i shpeshte tek meshkujt ne te gjithe boten. Ka pasur perpjekje per perdonimin e teknikave te depistimit per kete kancer nepermjet testeve biokimike. Gjithsesi, ende nuk ka rezultate te mira ne kete drejtim dhe me shume studime kerkohen per te vertetuar ndonje efektivitet te depistimit ne popullate me qellim uljen e vdekshmerise specifike nga kanceri i prostates dhe permiresim te cilesise se jeteses.

Jane gjithashtu duke u vleresuar metoda premtuese per kapjen e hereshme dhe depistimin e kanceret elekures dhe kanceret e gojes.

---

## RENDESIA E KAPJES SE HERESHME E KANCERIT TE GJIRIT

Qellimi i perdonimit te ekzaminimeve depistese eshte qe te kafen kanceret perpara se ata fillojne te jepin simptoma. Depistimi nuk eshte gje tjeter vecse perdonimi i nje testi, apo procedure per te identifikuar nje semundje, sic eshte kanceri, tek personat te cilën nuk kane asnjë simptomë.

Kanceri gjirit i cili kapet si pasoje e fillimit te shenjave klinike, ka shume gjasa te jetë me i perhapur, shpesht edhe pertej gjirit. Ne te kundert, kanceret e e gjirit te kapur gjate depistimit janë me te vegjel dhe shpesht te izoluar brenda gjirit. Madhesia e kancerit te gjirit dhe fakti se sa larg ai eshte perhapur ne organizem, janë faktoret me te rendesishem ne parashikimin e prognozës se një gruaje me kete semundje.

Te dhenat e paraqitura me poshte deshmojnë faktin se kanceri i gjirit se bashku me kancerin e qafes se mitres janë ndër kanceret me potenciale te medha sherimi sidomos ne rastet e kapjes se hereshme, cka deshmon per potencial te rendesishem ne uljen e letalitetit dhe te vdekshmerise nga ndërhyrja me sherbime depistimi Sherimi apo suksesi i trajtimit per kanceret per gjithesht matet permes treguesit te mbijetesës, e cila shpreh probabilitëtin e jetes pas pese vitesh nga momenti i diagnozes.

### Mbijetesa nga disa kancere


- Karcinoma e bronkeve: 6-12%
- Kanceri I gjirit: 60-80% ne varesi te aplikimit te depistimit
- Kanceri I stomakut: 8%
- Kanceri I kolonit dhe rektumit: 40-60%
- Kanceri I cerviksit: 65%-92% ne varesi te aplikimit te depistimit
- Kanceri I prostates: 30-40%
- Kanceri I laringsit/ezofagut: 60-70%

## SHPERNDARJA DHE PRIRJET E KANCERIT TE GJIRIT

Per te pershkruar peshen e kancerit te gjirit ne shendetin publik te nje vendi te caktuar si dhe per te bere krahasimet e nevojshme ne hapesire dhe kohe perdom kryesish treguesit e vdekhsmerise dhe semundshmerise. Vdekshmeria ose mortaliteti (vdekjet prej kancerit permbi popullaten ne te cilin ato kane ndodhur ne nje kohe te dhene) mund te gjendet duke perdonur skedat e vdekjeve, per te cilat ekziston nje ligj i vencante.. Ajo ndikohet si nga gjendja lidhur me me shpeshtesine e kancerit ne nje popullate (incidencia) ashtu edhe nga mbijetesen e prej tij (letaliteti). Per te vleresuar ne menyre specifike shpeshtesine e hasjes se kancerit te gjirit mund te perdoret edhe semundshmeria (rastet e diagnostikuara me kancer gjiri) ne formen e incidences (rastet e reja permbi popullaten ne te cilin kane ndodhur) ose te prevalences (te gjitha rastet, te reja dhe te vjetra ne ate popullate). Per perllogaritjen e semundshemrise eshte i nevojshem nje sistem i pershtatshem i informacionit spitalor qe ne rastin e kancereve shprehet me rregjistra specifike te kancerit.

Kanceri gjirit eshte kanceri qe haset me shpeshte ne grata e shumices dermuese te vende te botes, pavaresisht se ka diferenca te medha ne semundshmerine dhe vdekshmerine prej tij ne vende te ndryshme (shih figuren e meposhteme)

**Diferencat ne incidencen e hasjes se kancerit te gjirit ne vendet e ndryshme te botes. (Per 100 000).**



Ne Shqiperi per te vleresuar prirjet dhe perhapjen e kancerit te gjirit bazohemi ne te dhenat e vdekjeve te grumbulluara nga INSTAT dhe incidencen e rasteve te reja qe grumbullohen prane sherbimit te onkologjise ne QSUT ‘Nene Tereza’.

Gjithsesi si burim me i plote informacioni sherben sistemi i te dhenave mbi kanceret ne bote GLOBOCAN i cili perllogarit nje vleresim te situates reale ne cdo vend te botes duke marre per baze, nivelin e aksesit ne sherbime, cilesine e manget dhe boshlleqet ne statistikat kombetare.

### Pirja e kancerit te gjirit ne Shqiperi

Bazuar ne te dhenat e GLOBOCAN eshte verejtur nje rritje te shpejte ne numrat e kancerit te gjirit gjate 25 viteve te fundit ne Shqiperi.

Nga mesi i viteve 80 deri me sot numri i vdekjeve ne vit nga kanceri i gjirit eshte rritur me shume se 3 here. Nuk duhet harruar se ky eshte nje fenomen qe verehet edhe ne shumicen e vendeve ne zhvillim.

Ne nje pjese te madhe rritja ne perpjithesi e kancereve shpjegohet nga rritja e moshes mesatare, por ne rastin e kancerit te gjirit, rritja vijon te ngelet edhe pas menjanimit te efektit te moshes. Nje demostrim i kesaj dukuri verehet ne kolonen e fundit te tabelles se meposhteme

### Pirjet e vleresuara te kancerit te gjirit ne Shqiperi

Viti	Mortaliteti	Mortaliteti i standartizuar per moshen
1987	4.76	5.58
1988	3.81	4.72
1989	4.53	5.33
1992	4.5	5.16
1993	4.12	4.62
1994	3.9	4.56
1995	5.24	5.54
1996	5.55	6.07
1997	4.84	5.24
1998	5.57	6.03

1999	7.6	8.4
2000	7.82	8.52
2001	6.63	6.44
2002	6.79	6.47
2003	8.87	8.39

Burimi: GLOBOCAN

### Disa shifra mbi kancerin e gjirit ne Shqiperi

Ka nje dallim mjaft te madh mes te dhenave te GLOBOCAN 2008 dhe statistikave kombetare per Shqiperine.

Sipas GLOBOCAN vleresohej se duhet te kemi rreth 890 raste te reja ne vit me kancer gjiri dhe rreth 320 vdekje ne vit nga kanceri i gjirit. Prane sherbimit onkologjik identifikohen me pak se 500 raste te reja ne vit Nderkohe INSTAT nuk e publikon ne raportet e saj ne menyre specifike vdekshmerine nga kanceri i gjirit

## FAKTORET RISK PER KANCERIN E GJIRIT

Nje faktor risk eshte ai qe rrit shanset apo mundesite qe ka nje grua per te zhvilluar nje semundje, sic mund te jete edhe kanceri. Kancere te ndryshme kane faktore te ndryshem riku. Keshtu psh duhapirja eshte nje faktor riku per kancerin e mushkerive, kancerin e gojes, lарingsit dhe shume organeve te tjera, nderkohe qe ekspozimi i shtuar i lekures ndaj diellit eshte nje faktor riku per kanceret e lekures.

Por pasja e nje faktori riku apo edhe e disave nuk do te thote se personi do te zhvilloje pa tjeter semundjen. Shumica e grave te cilat kane nje apo me shume faktore riku per kancerin e gjirit nuk do te preken kurre nga ky kancer, nderkohe qe shume gra me kancer gjiri nuk duket te kene asnje faktor te dukshem riku (me perjashtim te faktit te te qenit grua dhe te moshimit)

Ka lloje te ndryshme faktoresh risk. Disa faktore sic mund te jete mosha e nje personi, nuk mund te ndryshohen. Disa jane te lidhur me sjelljen personale si psh duhapirja, alkooli dhe dieta. Te tjere jane te lidhur me faktore mjedisore qe mund te shkaktojne kancer. Disa faktore ndikojne tek riku me shume se te tjere dhe riku per kancer gjiri mund te ndryshoje me kalimin e kohes nderkohe qe ndryshon mosha apo stili i jeteses.

### Faktore riku te pandryshueshem

#### Gjinia

Megjithese kanceri i gjirit mund te verehet edhe tek burrat (100 here me rralle se tek grate), fakti i te qenit femer eshte determinanti kryesor qe rrit mundesite per kancer gjiri. Gjiri i femrave eshte vazhdimisht nen efektin e hormoneve femerore si estrogeni dhe progresteroni dhe ky duhet te jete faktori kryesor i riskut.

#### Mosha

Risku per te pasur kancer gjiri rritet me rritjen e moshes. Rreth 1 ne 8 kancere invazive te gjirit ne SHBA jane verejtur tek grate nen 45 vjec, nderkohe qe 2 ne 3 kancere te tillë gjenden ne grate mbi 55 vjec. Nje ide tjeter per rritjen e riskut me moshen e jep fakti i meposhtem; ne Kanada 1 ne 390 gra te moshes 35 vjec ka per tu diagnostikuar me kancer ne pese vitet e ardheshme, nderkohe qe per grate e

moshes 60 vjec mundesia per tu diagnostikuar me kancer ne pese vitet e ardheshme eshte 1 ne 80.

### Faktoret gjenetike

Reth 5% deri ne 10% e kancereve te gjirit mendohet te jene te trasheguar nga nje familjar si pasoje e nje defekti gjenetik.

Shkaku me i shpeshte hereditar apo i trasheguar eshte nje mutacion ne gjenet BRCA1 dhe BRCA2. Ne qelizat normale keto gjene parandalojne kancerin duke ndihmuar ne prodhimin e proteinave specifike qe ndihmojne qelizat te mos rriten ne menyre anormale.

Ne disa familje me mutacione BRCA risku i hasjes se kancerit te gjirit mund te jete deri ne 80%. Keto kancere priren te zhvillohen ne grata e reja dhe shpesh mund te prekin te dy gjinjte. Grata me kete defekt ka prirje te zhvillojne edhe kancere te tjera sidomos kancer te ovareve.

Ka edhe defekte ne gjene te tjera te identikuara si te lidhura me kancerin e gjirit, por jane shume me te rralla dhe nuk e rrisin riskun aq shume sa te mesipermit (ATM, p53, CHEK2, PTEN, CDH1)

Ende nuk ka rekondime perfundimtare mbi vleren e testimit gjenetik me qellim kapjen e hershme te ketyre difekteve dhe monitorimin perkates te grave ku ato hasen.

### Historia familjare per kancer gjiri

Grate te afermit e afert te gjakut te te cilave kane pasur kancer gjiri, kane nje risk me te larte se popullata e per gjitheshme. Risku i gruas pothuaj dyfishohet ne rastet kur nena apo motra ka pasur kancer gjiri. Risku trefishohet kur ka pasur dy raste te tilla ne familjaret e afert.

Megjithate vetem me pak se 15% e grave me kancer gjiri kane raportuar ne anamneze nje te aferm me kancer gjiri. Me shume se 85% nuk kane asnje te tille.

### Historia personale lidhur me kancerin e gjirit

Nje grua me kancer ne njerin gji ka nje risk 3-4 here me te larte per te zhvilluar nje kancer te ri ne gjirin tjeter apo ne nje pjesë tjeter te te njejtit gji. Kjo eshte e ndyshme nga rishfaqja e kancerit te pare.

## Indi i gjirit me densitet te larte

Grate me ind gjiri me densitet me te larte (sic mund te shihet ne mamogram) kane me shume material glandular dhe me pak ind dhjamor, dhe kane risk me te larte per kancer. Per fat te keq, indi i ngjeshur i gjirit e ben me te veshtire kapjen e problemeve ne mamogram.

## Disa probleme beninje te gjirit

Grate e diagnostikuara me probleme beninje te gjirit mund te kene nje risk me te rritur per kancer gjiri. Disa prej tyre kane risk shume te ulet se te tjerat. Tre kategorite e meposhteme ndihmojne per te idnetifikuar problemet me risk me te larte;

Lezionet joproliferative. Keto nuk shoqerohen me rritje te tepruar te indit te gjirit dhe ato nuk kane risk per kancer ose e kane ate shume te ulet. Ketu perfshihen

- Semundja fibrocistike (fibroza ose kiste)
- Hiperplazia e lehte
- Adenoza (jo sklerozuese)
- Fibroadenoma e thjeshte
- Tumori Phyllodes (beninj)
- Nje papillome e vetme
- Nekroza e dhjamit
- Mastiti
- Duct ektazia
- Tumore te tjere beninje (lipoma, hamartoma, hemangioma, neurofibroma)

Leziona proliferative jo atipike: keto leziona jepin rritje te tepruar te qelizave ne duktet apo lobulet e gjirit. Ato e rrisin pak riskun e gruas per kancer gjiri (50% deri ne 2 here)

- Hyperplasia duktale zakonshme (pa atipi)
- Fibroadenoma komplekse
- Adenoza sklerozante

- Papilomatoza

Leziona proliferative atipike. Ne keto leziona vec rritjes te tepruar te qelizave ne duktuset apo lobulet kemi edhe anormalitet te qelizav. Ato e rrisin mjaft riskun per kancer gjiri (deri ne 4-5 here)

- Hiperplazia atipike lobulare (ADH)
- Hiperplazia atipike lobulare (ALH)

Leziona jokanceroze te gjirit te tilla si karcinoma lobulare in situ (LCIS) e rrit 7 deri ne 11 here riskun per kancer gjiri.

#### Fillimi dhe mbarimi i menstruacioneve

Grate te cilat kane pasur me shume cikle menstruale per arsye se ato kane filluar me heret ne jete (para moshes 12 vjec) ose kane perfunduar me vone pas moshes (55 vjec) kane nje risk lehtesish me te larte. Kjo mund te kete lidhje me ekspozimin me te gjate ndaj hormoneve estrogen dhe progresteron.

#### Ekspozimi ndaj rrezatimit te gjoksit

Eshte verejtur se grate te cilat ne femijerine apo rinine e tyre i jane nenshtruar terapise me rrezatim per arsye te nje semundje tjeter kanceroze (si disa limfomat psh) jane ne risk me te larte. Risku eshte me i larte gjate adoleshences kur gjinjte jane ende duke u zhvilluar. Rrezatimi pas moshes 40 duket se nuk e rrit me riskun.

#### Dietilstilbestroli (DES)

Ky preparat eshte perdonur gjate viteve 1940 deri ne fillim te veteve 1970 per te parandaluar deshtimet ne lindje. Eshte verejtuar se ai rrit riskun per kancer gjiri tek grate qe jane ekspozuar ndaj tij.

#### Faktoret e riskut te lidhur me stilin e jetesës

#### Lindja e femijeve

Grate qe nuk kane pasur femije ose qe e kane pasur femijen e pare pas moshes 30 vjec kane nje risk lehtesisht me te larte per kancer gjiri. Shume shtatzani dhe shtatzanite ne moshe te hereshme duket se e ulin riskun. Ndoshta kjo eshte e lidhur me uljen e numrit total te cikleve menstruale si pasoje e shtatzanive.

#### Perdorimi recent i kontraceptiveve orale

Kontraceptivet orale e rrisin pak riskun por me kalimin e kohes risku normalizohet pas nderprerjes se perdorimit (pas 10 vitesh)

#### Terapia hormonale pas menopauses

Perdorimi i estrogenit (ndonjehere me progresteronin) si terapi zevendesuese eshte perdorur per shume kohe per ndihmuar uljen e simptomave te menopauses dhe per te parandaluar osteoporozën. Rritja e riskut per kancer gjiri eshte verejtur ne disa studime vetem ne perdorimin e kombinuar te hormoneve (jo estrogen vetem) nderkohe qe ashtu si per kontraceptivet orale risku piret te normalizohet brenda 5 vitesh nganderprerja e mjekimit.

#### Ushqyerja me gji

Disa studime deshmojne se ushqyerja me gji mund ta ule lehtesisht riskun nga kanceri i gjirit, sidomos nese vijon per 1 vit e gjysem ose dy vjet

#### Alkooli

Konsumi i alkoolit eshte pare te jete i lidhur qarte me riskun e rritur per kancer gjiri dhe rritja e riskut ndjek volumin e alkoolit te konsumuar. Nje gote ne dite nuk e rrit ne menyre sinjifikative riskun, por ato qe pijne 2-5 gota ne dite e kane riskun 50% me te larte. Te mos harrojme alkooli i tepruar rrit riskun edhe per kancere te tjere si i gojes fytit ezofagut dhe heparit.

#### Mbipesha

Rritja e riskut per kancer gjiri nga mbipesha eshte sidomos e dukshme pas menopauses. Mesa duket shpjegimi duhet te jete fakti se shumica e estrogenit pas menopauses vjen nga indi dhjamor (dhe jo nga vezoret). Eshte verejtur se dhjami i shtuar ne zonen e belit eshte me i rrezikshem se ai ne zonen e kembeve. Kontrolli i

dietetes dhe aktiviteti fizik mund te mb ajne ne kontroll depozitimin e indit dhjamor dhe mund te parandalojne ne kete menyre nje perqindje te kancereve te gjirit.

### Aktiviteti fizik

Jane duke u shtuar faktet qe deshmojne se aktiviteti fizik ne formen e ushtrimeve e ul riskun per kancer gjiri.

### Dieta dhe vitaminat

Jane kryer shume studime per te gjetur nje lidhje mes disa lloje dietash dhe kancerit por rezulatat ende nuk jane te forta dhe konkluzive. Disa studime deshmojne se dieta luan nje rol, sidomos studimet gjeografike te cilat verejne nje risk me te ulur ne vendet ku dieta tradicionalisht eshte e varfer me yndyrna te saturuara. Gjithashtu duket se kalorite ditore kane nje lidhje te lehte me kancerin e gjirit ndoshta permes krijimit te mbipeshes.

Gjithsesi studimet nuk arrijne te provojne diferenca ne dietat e ndrshme te te njejtit komunitet dhe sidomos marrja e vitaminave si supplement nuk duket te luaje ndonje rol.

Me shume studime nevojiten ne kete fushe.

### Duhanpirja

Nuk ka te dhena konkluzive per nje lidhje mes duhanit dhe kancerit te gjirit. Disa studime kane gjetur lidhje por ende kjo kundershtohet nga studime te tjera.

Ministria e shendetise e SHBA ne 2006 konkludonte se ka te dhena jot e mjaftueshme ne kete fushe.

### Puna naten

Disa studime te koheve te fundit sugjerojne se grate qe punojne naten si psh infermjeret e turnit te nates kane nje rrisk me te larte te kancerit te gjirit. Edhe ne kete rast te dhenat jane te pamjaftueshme, pavaresisht teorive te lidhura me influencen e hormoneve te tilli si melatonina, nje hormon i ndikuar nga dritat e diellit, gjate punes naten.

Antiperspirantet, rexhisenat dhe implantet e silikonit

Ende nuk ka studime shkencore qe te mbeshtesin teorine se antiperspirantet apo deodorantet qe perdoren ne sjetulla mun dte rrisin riskun per kancer gjiri. E njejta gje vlen edhe per rexhisenat apo implantet e silikonit

## SHENJAT DHE SIMPTOMAT E KANCERIT TE GJIRIT

Ne Shqiperi, ku perhapja e perdonimit te mamografise si mjet depistues eshte ende shume e kufizuar, shumica derrmuese e kancereve diagnostikohen si pasoje e fillimit te shenjave klinike.

Shenja me e zakoneshme e kancerit ne gji eshte nje mase apo nje kokerr. Nje mase qe eshte e padhimbshme, e forte dhe ka kufij te parregullt ka shume gjasa te jete kanceroze, por canceret e gjirit mund te jene te bute dhe te rumbullaket gjithashtu. Per kete arsye eshte e rendesishme qe cdo mase apo kokerr e re apo edhe ndryshim tjeter i gjirit te kontrollhet nga nje mjek specialist me eksperience ne diagnozen e semundjeve te gjirit.

Shenja te tjera te mundshme te kancerit te gjirit jane:

- Enjtje e nje pjese apo e gjithe gjirit (edhe ne se nuk ndjehet ndonje mase)
- Irritim apo demtim tjeter i lekures se gjirit
- Dhimbre ne gji apo ne thithin e gjirit
- Gropezim (kthim nga brenda) e thithit
- Skuqje, trashje apo zenie kore e thithit apo lekures se gjirit
- Rrjedhje nga gjiri qe nuk eshte qumesht

Duhet theksuar se keto shenja nuk jane specifike dhe ne 90% te rasteve ato verehent edhe ne individe tek te cilet nuk diagnostikohet asnje kancer gjiri.

Disa here kanceri i gjirit mund te shtrihet ne gjendrat limfatike nenkrah dhe te shkaktoje fryrje apo enjtje atje, edhe para se tumorri original ne indin e gjirit te jete aq i madh sa te mund ta ndjesh. Gjendrat limfatike te enjtura duhen konsideruar gjithashtu ne shenje e mundshme kanceri dhe duhen verifikuar me kujdes nga mjeku.

---

## PROCEDURAT E DEPISTIMIT

Mamografja, ekzaminimi klinik i gjirit dhe veteekzaminimi i tij jane procedura te perdonura gjeresisht si praktika depistuese.

Teknika te tjera me potencial depistimi si rezonanca magnetike apo ECHO e gjirit nuk rekomandohen deri me sot per perdonim masiv

## MAMOGRAFIA

Mamografia eshte nje radiografi e gjirit dhe perdon teknologjine e mirenjohur te rrezeve rentgen apo x. Nje mamografi diagnostikuese perdoret per te diagnostikuar semundje te gjirit tek nje grua qe ka shenja klinike ne gji apo nje rezultat anormal ne mamografine depistuese. Mamografia depistuese perdoret per te kerkuar per kancer gjiri ne grate qe jane asimptomatike; pra qe nuk duket te kene shenja problematike lidhur me gjirin. Mamografite depistuese zakonisht kerkojne dy pamje (fotografi rentgen nga kende te ndryshme) per secilin prej gjinjve. Edhe grate qe ushqejne femjet me gji mund ti nenshtrohen mamografise, vetem se ato kane gjase te jene me pak te sakta per arsyen se indi i gjirit eshte me i ngjeshur.

Mamografite moderne perdonin nivele shume te ulet te rrezatimit dhe ekspozimi ndaj keti rrezatimi nuk shkakton asnje rritje sinjifikative te riskut per kancer gjiri. Nje shembull krahasues per kete do te ishte ekspozimi ndaj rrezatimit ne nje udhetim me avion nga Tirana ne Nju Jork. Ky rrezatim do te ishte pak a shume i barabarte me ate nje mamografie.

Per kryerjen e nje mamograme, gjiri kompresohet mes dy pllakaveper ta shtrire dhe perhapur indin e gjirit. Megjithese eshte pak i papelqyeshem si moment eshte i redesishem per te arritur nje mamogram te mire dhe te lexueshme. Shtypja zgjat vetem pak sekonda. E gjithe procedura per nje mamografi depistuese zgjat rreth 20 minuta.



Procedura prodhon nje imazh bardh e zi te indit te gjirit ose ne nje film klasik te tipit te radiografise ose ne imazh dixhital kompiuterik (ne rastin e mamografise dixhitale). Ky lexohet ose interpretohet nga nje radiolog i kualifikuar. Radiologu ne kete imazh do te kerkonte te shohe disa lloje ndryshimesh ne indin e gjirit:

- Kalcifikime te cilat duken si pika te bardha ose te zbehta ne film. Ato mund te jene shkaktuar ose jo nga kanceri dhe jane dy tipash;
  - Makrokalcifikimet qe jane depozita te medha kalciumi qe me shume gjasa perfaqesojne ndryshime degenerative ne gji te tilla si sklerotizim i arterieve te gjirit, demtime te vjetra ose inflamacione te vjetra. Keto depozita jane beninje dhe nuk kerkojne biopsi per diagnoze te metejshme. Makrokalcifikimet gjenden ne rreth gjysmen e grave mbi 50 vjec dhe ne rreth 1 ne 10 gra te moshes nen 50 vjec.
  - Mikrokalcifikimet jane gjurme te vogla te kalciumit ne gji. Ato mund te shfaqen te vetmuara ose ne grupe. Mikrokalcifikimet kur kafen ne nje mamografi jane me shqetesuese por jo gjithmone nenkuftojne ekzistencen e nje kanceri. Forma dhe shtrirja e tyre ndihmojne radiologun te gjykoje mbi mundesine e nje kanceri. Ne shumicen e rasteve ato nuk kerkojne biopsi. Vetem kur duken te dyshimta per kancer do te duhet biopsia.
- Nje mase, e cila mund te shoqerohet ose me kalcifikime, eshte nje ndryshim tjeter i rendesishem i verejtur ne mamografi. Ato mund te jene shenje per shume gjera qe nga cistet tek tumoret beninje (si fibroadenomat). Masat qe nuk jane ciste zakonisht nevojiten te ndiqen me biopsi.

Nje cist dhe nje tumor duken shume te ngjashem si ne ekzaminimin fizik ashtu edhe ne mamografi. Per te dalluar cistin nga tumor, kerkohet nje ECHO e gjirit ose nje aspirim i fluidit te cistit me nje shiringe te holle.

Nese nje mase nuk eshte cist i thjeshte (cka do te thote qe te pakten e nje mjesi e saj eshte solide) atehere mund te jene te nevojshme disa imazhe te tjera. Disa masa ndiqen me mamografi periodike te shpeshta ndersa disa mund te kene te nevojshme biopsine. Radiologu gjykon permes madhesise, formes dhe kufinjve te mases.

Mamografite e kryera me pare ndihmojne radiologun per te gjykuar nese nje mase apo kalcifikimet kane ndryshuar apo jo. Mungesa e ndryshimeve per disa vjet deshmon per nje problem beninj dhe ne kete rast nuk do te kishte nevoje per biopsi.

Mamografia nuk eshte mjeti me i persosur per vendosjen e diagnozes se kancerit te gjirit, kjo eshte sidomos me e vertete per grata e reja ku gjiri eshte me densitet me te larte dhe mund te fshehe tumorin. Biopsia eshte e nevojshme per vendosjen perfundimtare te diagnozes.

Do te ishte gjithmone e pershatshme qe te zgjidhej per te kryer mamografine nje moment kur gjinjte nuk jane te fryre apo te dhimbshem. Duhen brenda mudesive te

shmangen ditet para periodave. Ne diten e ekzaminimit nuk keshillohen te perdoren deodorante pasi disa prej tyre mbajne substanca qe mund te interferojne me leximin e mamografise. Veshja duhet te jete e pershtatshme (fund apo pantallona ne vend te fustanit psh) ne menyre qe te lethesoje procedurat e ekzaminimit te gjirit. Keshillohet gjithashtu per grate qe kane kryer mamografi te tjera te kene filmat e tyre me vete per ti konsultuar me radiologun.

Gjithmone duhet keshilluar gruaja qe te raportoje tek radiotekniku qe kryen mamografine cdo problem shqetesues, simpotme opo histori kirurgjje apo perdonimi medikamentesh

Per kryerjen e nje mamografie eshte i nevojshem nje radioteknik i kualifikuar i cili ndihmon ne vendosjen e gjirit ne pozicionin e pershtatshem per kryerjen e mamografise. Keshillohet qe shumica e radioteknikeve te jene femra per te lethesuar aksesin e popullates ne depistimine me mamografi.

### Epidemiologjia e mamografive depistuese

Vetem 2-4 mamografi depistuese ne 1000 te tilla cojne ne diagnozen e kancerit. Reth 10 % e grave qe kane kryer nje mamografi do te kene nevoje per teste te tjera por shumica e tyre do te kete nevoje vetem per nje mamografi shtese. Vetem 10% e ketyre grave do te kene nevoje per biopsi. Nga ato qe do te kryejne nje test biopsie dhe shumica derrmuese e biopsive (80%) nuk do te jene kancer.

## EKZAMINIMI KLINIK I GJIRIT

Ekzaminimi klinik i gjirit mund te kape disa kancere te gjirit ne stade relativisht te hereshme te zhvillimit te semundjes dhe mund te kape gjithashtu disa kancere te cilet nuk jane evidente ne mamografi. Gjithsesi efektiviteti i kesaj procedure varet mjaft nga ekzaminimi sistematik i te gjithe kuadrateve ne te dy gjinjte si dhe gjithe paketat limfatike rajonale.

Nje ekzaminim sistematik eshte paraqitur ne tabelen e meposhteme

Rajoni i ekzaminuar	Fokusi	Procedura dhe teknikat
Gjinje	Inspektohen GJINJTE, AREOLA dhe THITHI	<p>Gruaja eshte e ulur dhe e zhveshur deri ne mes.</p> <p>Inspektohen gjiri, areola dhe thithi. Inspektimi kryhet nga nje pamje ballore dhe anesore:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Me krahet hapur anash</li><li>2. Me krahet ngritur mbi koke</li><li>3. Me duart shtrenguar tek ijet Ose</li><li>4. VETEM NE RAST SE gjinje jane shume te medhenj ose te ngritur: keshillohet gruaja te te perkulet perpara gjate inspektimit</li></ol>


AKSILAT (sqetullat)	Inspektohen AKSILAT	Inspektohet lekura e aksilave me krahet te ngritur mbi koke
GJENDRAT LIMFATIKE AKSILARE	Palpim  CENTRAL  PEKTORAL  SUBSCAPULAR  GJENDRAT LIMFATIKE LATERALE	<p>Mbahet dora e majte dhe kyti i gruas me doren e majte per te ekzaminuar aksilen e majte. E kunderta per aksilen e djathte.</p> <p>Nje pozicion tjeter i pershtatshem do te ishte gruaja e shtrire me doren te vendosur mbi balle (fig)</p> <p>Bashkohen gishtat ne forme kupe . Kontrollohet sa me larte qe te jetë e mundur ne aksile.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>5. Kalon gishtat poshte mbi brinje me qellim ndijimin e noduleve CENTRALE</li> <li>6. Ndjen brenda shtreasave aksiliare anteriore (PEKTORALE)</li> <li>7. Ndjen brenda shtreasave aksiliare posteriore (SUBSCAPULARE)</li> <li>8. Ndjen pjesen ne kontakt me humerusin (LATERALE)</li> </ul>
NODULET LIMFATIKE INFRAKLVIKULARE	Palpim  INFRAKLVIKULAR	Palpohet me mollezat e gishtave ne nderhapesiren e pare brinjore ne te dy anet (bilateral) per nodule INFRAKLVIKULARE.
NODULET LIMFATIKE SUPRAKLVIKULARE	Palpim  SUPRAKLVIKULAR	Palpohet me mollezat e gishtave ne te dy anet (bilateral) per nodule SUPRAKLVIKULARE mbi klavikul
Gjinje	Inspektim	Gruaja e shtrine NE SHPINE pa jastek nen koke. Mund te perdoret

	<p>i</p> <p>GJINJVE, AREOLAVE THITHIT (njesoj me me siper)</p>	<p>nje jastek i vogel nen shpatull ne anen qe po ekzaminohet per te zhvendosur gjinjte drejt qendres. <b>(NUK DUHET PERDORUR JASTEK NESE GJINJTE JANE TE VEGJEL).</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Inspektohen gjinjte.</li> </ol>
	<p>Palpim</p> <p>I</p> <p>GJINJVE, AREOLES, THITHIT dhe LIDHJES SE GJIRIT ME SQETULLEN</p>	<p>Palpohet seicili gjji:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>2. Gruas i kerkohet te hape krahun larg trupit ne anen qe po ekzaminohet</li> <li>3. Perdoren pjesa e brendeshme e kater gishtave, dhe me levizje rrethore, shtrengohet indi i gjirit.</li> <li>4. Perthyrja e nevojshme kryhet ne nivelin e kycit te dores, nderkohe qe gishtat mbahen pa levizur</li> <li>5. Aplikohet shtypje e moderuar dhe mbahet kontakti konstant me lekuren</li> <li>6. Levizet para dhe prapa permes gjirit ne linje te drejt duke bere rrathe te vegjel konstante</li> <li>7. Me pas zhvendoset dora rreth nje gisht me poshte .. e keshtu me rradhe</li> <li>8. Mbulohet gjithe zona nga poshte klavikules deri ne 3 cm poshte gjirit nga linja anteriore aksilare deri ne linjen midsternale:</li> </ol>

		a) Indi i gjendres b) zona areolare c) thithi d) lidhja e gjirit me sjetullen
--	--	---

Pozicioni i pacientit dhe drejtimi i palpimit


Figura lart tregon kontrollin e pjeses laterale te gjirit. Ajo poshte kontrollin e pjese mediale. Shigjetat tregojne drejtimin vertikal te zhvendosjes se dores.



...


Teknika e palpimit

Tre gishtat e mesit bejne levizje te rregullta rrotulluese me madhesine e nje monedhe 50 lekeshe.




Nivelet e presionit te ushtruar per kontrollin e seksioneve te ndryshme te indit te gjirit

Ekzaminuesi duhet te kryeje tre rrathe ne te njejtin vend te gjirit; nga me i lehti per kontrollin e pjeses siperfaqesore deri ne ne me te forin per kontrollin e indit te gjirit prane brinjeve.



## Drenimi limfatik i gjirit



## Palpimi i gjendrave limfatike supraklavikulare dhe infraklavikulare

Ushtrohet presion me gishtat dhe kryhen levizje te vogla rrotulluese siper dhe poshte klavikules



## Palpimi i gjendrave aksilare

Instruktohet gruaja te leshoje krahun dhe te marre fryme thelle per te lethesuar relaksimin. Mbahet krahu dhe berryli i gruas me doren e lire (qe nuk ekzaminon) per te siguruar relaksim optimal



Gjendrat aksilare palpohen duke ushtruar presion te thelle dhe duke kryer levizje rrethore me mollezat e tre gishtave te mesit. Ekzaminimi mbulon te kater kendet e sqetulles qe te kujton formen e nje diamanti. Ndiqet rradha e pershkruar me siper ne tabele dhe ne figuren e meposhte me kater stade.



#### Rezultatet e ekzaminimit te gjendrave limfatike

Gjendrat limfatike jane zakonisht te vogla me pak se 1 cm, te buta dhe te levizeshme. Inflamimi apo infektimi i tyre zakonisht shoqerohet me fiksim apo palevizshmeri te tyre dhe kjo duhet te konsiderohet nje shenje e dyshimte. Gjithmone duhet pare per madhesine, formen dhe levizshmerin e gjendrave

---

## NDERGJEGJESIMI MBI GJIRIN DHE VETE-EKZAMINIMI I TIJ.

Duke filluar nga mosha 20 vjec grave u duhet folur mbi perfitimet dhe kufizimet e vete-ekzaminimit te gjirit. Grate duhet te dine se si duhet te duken dhe te ndihen gjinjte e tyre normalisht dhe duhet te raportojne cdo ndryshim qe verejne ne gji tek mjeku, menjehere sapo e zbulojne ate. Gjetja e nje ndryshimi ne gji nuk do te thote domosdoshmerisht qe kemi te bejme me kancer. Mund te kete shume shkaqe te tjera per kete.

Nje grua mund te dalloje ndryshime duke njojur mire sesi duken apo ndihen normalisht gjinjte e saj (ndergjegjesimi mbi gjirin) apo duke perdorur nje teknike te thjeshte dhe sistematike per te ekzaminuar vete gjinjte e saj.

Teknika e kapjes se hereshme permes vete ekzaminimit te gjirit eshte perdorur gjeresisht ne shume vende por studimet e vleresojne ate si me efikasitet shume te ulet per kapjen e kancerit te gjirit dhe me riskun e rritjes se ankthit te panevojshem tek grate e shendetshme.

Nje grua ka drejten shendetsore te ndergjegjesohet mbi gjirin si dhe mund te zgjedhe te perdore tekniken e vete-ekzaminimit te gjirit per kapjen e hereshme te kancerit te gjirit. Ne te dy rastet eshte detyra e mjekut per ta keshilluar ate profesionalisht.

Informacioni i meposhtem do te mbeshteste mjekun e sherbimeve paresore per te keshilluar si duhet grate. Per me teper grade qe ekzaminojne gjinjte e tyre duhet ta rishikojne tekniken qe perdonin gjate kontrollit dhe ekzaminimit periodik tek mjeku:

Koha me e pershatshme per nje grua per te ekzaminuar gjinjte e saj eshte kur gjinjte nuk jane te dhimbshem apo te enjtar.

Sa here qe nje grua veren ndryshime ne gjinjte e saj duhet te kerkoje menjehere keshillen e mjekut

Si te ekzaminohen gjinjte nga vete gruaja ne kushte shtepiake

Gruaja shtrihet ne shpine dhe vendos krahun e djathte pas kokes. Ekzaminimi kryhet kur jemi shtrire dhe jo ne kembe per arsy se ne kete menyre indi i gjirit shperndahet ne menyre me uniforme mbi kafazin e kraharorit dhe eshte sa me i holle qe te jete e mundur, duke lethesuar ekzaminimin e gjithe indit me ane te gishtave.

Perdoren mollezat e tre gishtave te mesit te dores se majte per te ndjere ndonje kokerr ne gjirin e djathte. Perdoren levizje rrethore me madhesine e nje monedhe 50 lekeshe te mollezave te gishtave per te ndjere gjithe masen indore te gjirit.

Perdoren tre nivele te ndryshme presioni gjate ndjerjes se indit te gjirit; presion i lehte per pjesen indore me afer lekures, presion i mesem per pjesen pak me thelle dhe presion i forte per pjesen ngjitur me brinjet. Eshte normale qe pjesa e kurbes se poshteme te secilit gji te ndjehet me e forte. Nderkohe, per cdo gje tjeter e pazakonte duhet kerkuar mendimi i mjekut.

Levizja rrotulluese e permendur me siper kryhet per gjate gjithe gjirit duke pershkruar rrathe te vegjel nga lart poshte. Fillohet ne kete menyre nga pjesa e sqetulles dhe mbulohet me levizje gjithe gjiri deri ne mes te sternumit apo parzmit te kraharorit.

Sigurohu qe eshte kontrolluar gjithe zona e gjirit nga klavikula apo kularthi deri poshte ku ndihen vetem brinjet.


Perseritet ekzaminimi i pershkruar edhe per gjirin e majte duke vendosur krahun e majte poshte kokes dhe duke perdorur mollezat e gishtave ted ores se djathte per te kryer kontrollin

Vrojtimi apo inspektimi i gjirit kryhet duke qendruar perballë një pasqyre me duart te shtrenguara fort ne mes. Verehet gjiri per ndryshime ne madhesi, forme, konturet, skuqje apo zenie kore te thithit apo te lekures se gjirit. Shtrengimi i duarve ne mes kontrakton muskujt ne murin e kraharorit dhe zmadhon cdo ndryshim te mundshem te gjirit.

Ekzaminohet cdo sqetull kur jemi ne kembe apo ulur me krahun te ngritur lehte ne menyre qe ndjeni sa me shume ne indet e kesaj zone. Ngritja e krahut shume larte i tendos indet e sqetulles dhe e ben me te veshtire ekzaminimin.

Procedura e pershkruar ketu eshte e ndryshme nga teknika te tjera qe jane perdorur me pare ne disa vende dhe eshte e mbeshtetur ne literatoren me te fundit si dhe ne opinionet e eksperteve ne Shtetet e Bashkuara. Duket se ka fakte se ky pozicion (i shtrire), zona e mbuluar, teknika e ekzaminimit dhe presionet e ndryshme te perdorura e rrisin mundesine e gruas per te identifikuar anomalitete ne gji.





---

NJE PERMBLEDHJE MBI PRIORITIZIMIN E POLITIKAVE SHENDETORE DHE TEKNIKAVE TE NDERHYRJES LIDHUR ME DEPISTIMIN PER KANCER GJIRI.

---

Kanceri i gjirit eshte kanceri me i shpeshte tek femrat ne shumicen derrmuese te vendeve te botes dhe ka disa metoda nepermjet te cilave mund te kapet heret

Nese ekzistojne mundesite infrastrukturore dhe profesionale, depistimi me mamografi, mbeshtetur ose jo me ekzaminimin klinik te gjirit, plus ndjekja e individeve me rezultate positive apo te dyshimta, do te reduktonte mortalitetin nga ky kancer tek grate e moshes 50-69 vjec me pothuaj nje te treten (IARC). Perfitimi maksimal arrihet duke kryer depistim cdo 2-3 vjet. Efektiviteti i depistimit per grate e moshes 40-49 nuk eshte shume i qarte (IARC).

Ekzaminimi fizik i gjirit nga doktoret eshte deshmuar te jape perfitime shendetsore tek grate ne te 50-at (Shapiro 1997).

Disa studime te viteve 90 mbeshtesin idene se grate e te gjitha moshave kane perfitime shendetsore nga aplikimi sistematik i vete-ekzaminimit te gjirit (Gastrin 94, Harvey 97). Megjithate, nje studim i koheve te fundit ne Kine nuk deshmoi ndonje ulje ne vdekshmerine nga kanceri i gjirit si pasoje e vete-ekzaminimit te gjirit. Bazuar ne keto fakte mund te thuhet se nje program qe do te bazohej vetem tek inkurajimi i vete-ekzaminimit te gjirit nuk do te silte ndonje ulje te vdekshmerise nga ky kancer. Gjithsesi, grate duhet te keshillohen me force te kerkojne ndihme mjekesore, menjehere nese ato verejne ndonje ndryshim te dyshimte per kancer ne gjinje e tyre.

Mamografia eshte nje ekzaminim relativisht i shtrenjtë qe kerkon sidomos shume kujdes dhe ekspertize si gjate kryerjes ashtu edhe gjate interpretimit te rezultateve. Per kete arsye nuk eshte nje opsjon i mundshem depistimi per shume vende. Megjithese te dhenat shkencore mbi efektivitetin e ekzaminimit klinik te gjirit si metode e vetme depistimi, nuk jane te plota (IARC) ka arsye te besohet se ekzaminimi klinik i gjirit i kryer mire nga mjeke apo infermiere te trajnuar mund te luaje nje rol te rendesishem ne uljen e vdekshmerise. Eshte verejtur ne nje studim psh se shtimi i mamografise tek grate qe ekzaminoheshin klinikisht nga mjeket ne menyre sistematike, nuk ka sjelle reduktim shtese te vdekshmerise (Miller 2000).

Bazuar ne nivelin e deritanishem te njohurive shkencore, nje program kombetar kontrolli mbi kanceret duhet te inkurajoje diagnozen e hereshme apo kapjen e hereshme te kancerit te gjirit me fokus ne grate e moshave 40-69 vjec nepermjet ekzaminimit klinik te gjirit ne qendrat shendetsore apo spitalet. Gjithashtu duhet te promovohet ndergjegjesimi ne komunitet.

Lidhur me mamografine, puna duhet priorituar ne varesi te ekzistences se mjeteve dhe aftesive profesionale; se pari, kjo teknike duhet perdorur si mjet diagnoze paraprake, per grata te cilat jane konsideruar te dyshimta ose positive ne ekzaminimin klinik ne qendra shendetvore apo gjate vete-ekzaminimit ne shtepi. Nuk duhet harruar se kanceri mund te jete i pranishem edhe nese mamografia rezulton normale apo negative. Mamografia si mjet depistimi primar masiv ne popullate do te duhej te perdorej vetem atehere kur burimet jane te tilla qe te sigurojne depistim te cilesise se mire ne te pakten 70% te popullates target (grate 50-69 vjec).

Nuk duhet harruar gjithashtu se depistimi i kancerit te gjirit eshte ne vetevete me pak efektiv se sa depistimi i kancerit te qafes se mitres. Nje princip i per gjithshem i prioritizimit mes dy depistimeve do te ishte; perfitimet nga programi i depistimit per kancerin e gjirit dhe nga ai i qafes se mitres do te ishin te barabarta nese vdekshmeria nga kanceri i gjirit do te ishte rreth 3 here me e larte se ajo nga kanceri i qafes se mitres ne te njejtat grupmosha.

Gratë që nuk kanë asnjë faktor rreziku, kanë një rrezik mesatar për të zhvilluar kancer gjiri.

**Atyre ju rekomentohet:**

**Nëse janë 20-40 vjeç**

- Ekzaminim klinik te personeli mjekësor çdo tre vjet
- Vetëkontontroll mujor të gjirit

**Nëse janë 40-50 vjeç**

- Ekzaminim klinik te personeli mjekësor çdo vit
- Vetëkontontroll mujor të gjirit

**Nëse janë 50-70 vjeç.**

- Mamografi çdo 2 vjet
- Ekzaminim klinik te personeli mjekësor çdo vit
- Vetëkontontroll mujor të gjirit

**Gratë që kanë disa faktorë rreziku, si histori familjare apo personale, probleme beninje të gjirit, fillimi i hershëm dhe mbarimi i vonshëm i menstruacioneve, moslindje ose lindja e fëmijës mbi 30 vjeç, obezitet, ind te ngjeshur te gjirit dhe ekspozim ndaj rrezatimit terapeutik kanë një rrezik më të larte se mesatarja për të zhvilluar kancer gjiri.**

**Atyre ju rekomentohet:**

- Ekzaminim klinik te personeli mjekësor çdo vit
- Konsultë me specialistin e gjirit
- Mamografi (dhe ekografi nese eshte e nevojshme) çdo vit nga 40 vjeç
- Vetëkontroll mujor i gjirit

**Nëse grate kanë faktorë gjenetike, janë bartës të difektit BRCA1 apo BRCA 2, kancer gjiri tek një familjar mashkull, kancer gjiri dhe kancer vezoresh në të njëjtin person, në dy ose më shumë familjarë të ngushtë ju rekomandohet:**

- Ekzaminim klinik i gjirit çdo gjashtë muaj
- Mamografi dhe/ose rezonancë magnetike çdo vit nga 25 vjeç
- Konsultë me specialistin e gjirit dhe specialistin gjenetik

TABELA E VLERESIMIT TE RISKUT DHE REKOMANDIMET PER DEPISTIM

Risku relativ (RR)	Depistimi i rekomanduar
I - Risk mesatar (RR=1)	Rekomandimi
Gra pa asnjë nga faktoret risk te meposhtem	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ekzaminim klinik i gjirit cdo tre vjet per grata 20-40 vjec dhe cdo vit per ato mbi 40 vjec</li> <li>Mamografi cdo dy vjet duke filluar nga mosha 50 vjec</li> </ul>
II - Risk pak i rritur (RR 1.1 – 3)	Rekomandimi
1. Historia klinike <ul style="list-style-type: none"> <li>Lezione joproliferative</li> <li>Lezione proliferative pa atipi</li> </ul> 2. Faktore te lidhur me riprodhimin <ul style="list-style-type: none"> <li>Menarka para 12 vjec</li> <li>Menopauza pas 55 vjec</li> <li>Terapi zevendesuese me hormone te kombinuar (shih me siper) per te pakten 2 deri 5 vjet (perdorim i tanishem ose recent)</li> <li>Nulipare ose lindja e pare mbi 30 vjec</li> </ul> 3. Historia familjare <ul style="list-style-type: none"> <li>Nje i aferm i rendit te pare (nene, moter, vajze) me kancer gjiri (pas moshes 50 vjec).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ekzaminim klinik i gjirit si me siper</li> <li>Konsidero fillimin e mamografise qe ne moshen 40 vjec dhe perseritje cdo vit</li> </ul>

<p>4. Faktore te tjere risk</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dy deri ne pese piye alkoolike ne dite</li> <li>• Obezitet sidomos pas menopauzes</li> </ul>	
<p><b>III - Rritje e forte e riskut relativ (RR i barabarte ose mbi 3)</b></p>	<p><b>Rekomandimi</b></p>
<p>1. Historia klinike</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Histori personale kanceri gjiri (invaziv ose DCIS)</li> <li>• Lobular Karcinoma in situ (LCIS)</li> <li>• Hiperplazi atipike lobulare apo duktale (ADH ose ALH)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekzaminim klinik i gjirit cdo vit</li> <li>• Mamografi cdo vit pas diagnozes</li> </ul>
<p>2. Faktore te tjere klinike</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rezatim terapeutik i gjoksit para moshes 30 vjec (per semundje Hodgkin etj)</li> <li>• Densitet i larte i gjirit (mbi 70%) i pare ne mamogram</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekzaminim klinik i gjirit cdo vit</li> <li>• Mamografi cdo vit (ne asnje rast jo para moshes 25)</li> <li>• Konsulte me specialistin e gjirit</li> </ul>
<p>3. Histori familjare</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Familjar me kancer gjiri nen moshen 50 vjec</li> <li>• Dy ose me shume familjare te se njejtes dege me kancer gjiri</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekzaminim klinik te gjirit te pakten cdo vit</li> <li>• Mamografi cdo vit duke filluar qe 40 vjec ose 5 deri 10 vjet me pare se fillimi i kancerit tek familiaret (ner asnje rast jo para moshes 25)</li> <li>• Konsulte me specialistin e gjirit</li> </ul>
<p>4. Faktore gjenetike</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bartes i njohur ose familjar i rendit te pare me nje bartes te difektit BRCA1 apo BRCA 2</li> </ul> <p>Tregues te tjere per vleresim gjenetik te riskut te kancerit</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Histori personale e kancerit te gjirit nen moshen 45 OSE kancer gjiri ne nje apo me shume</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekzaminim klinik te gjirit cdo gjashte muaj</li> <li>• Mamografi dhe/ose rezonance magnetike cdo vit nga 25 vjec</li> <li>• Konsulte me specialistin e gjirit dhe specialistin gjenetik</li> </ul>

familiare nen moshen 45 vjec

- Histori personale e kancerit te vezoreve ose kancerit primar peritoneal OSE kancer vezores apo kancer primar peritoneal ne familjare te ngushte
- Kancer gjiri tek nje familjar mashkull
- Kancer gjiri ne dy ose me shume familjare te dy diagnostikuar para moshes 50 vjec
- Kancer gjiri ne tre ose me shume familjare te cdo moshe
- Kancer gjiri dhe kancer vezores ne te njejtin familjar ose ne dy ose me shume familjare te ngushte
- Hasje e kancerit te gjirit se bashku me kancerin e tiroideve kancerin endometrial, kancerin e kockave, sarkomen, karcinomen adrenokortikale, kancerin e trurit, kancerin e stomakut, leucemia akute me fillim te hershem, te gjitha ne te njejten dege familjare